




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.1634 Akti
Datë 08.09.2014

Nr.1526 Vendimi
Datë 14.10.2014



V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI (RROKAJ)

asistuar prej sekretares gjyqësore Milena Mersini, sot më datë 14.10.2014 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile nr.1634 Akti, që u përket palëve:

PADITËSE: Shoqëria ‘R&M’ sh.p.k, përfaqësuar nga administratori Robert Marku, identifikuar me kartën e identitetit mr n.G50515105 J, me adresë, lagjia ‘Liri’ Fier.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me adresë ‘Lagjia ‘Apollonia’ Rruga ‘Brigada e 11 Sulmuese’ (në mungesë);

OBJEKTI: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.8633 prot, datë 04.06.214 nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për faljen e gjobave në vlerën 620.000 lekë të përcaktuar në këtë akt administrativ.


Baza ligjore: Neni 324 e vijim, i K.Pr.Civile, nenet 7,11,15,16,17,18 e vijim i ligjit nr.49/2012 ”Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nen 73 e vijim i ligjit 9920, datë 19.05.2008 ‘për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’ i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.24, datë 02.09.2008, nenet 113,115,116 e vijim i K.Pr.Administrative.

Gjykata pasi lejoi marrjen në shqyrtim dhe administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e përfaqësueses së palës paditëse, përfaqësuesit ligor të shoqërisë ‘R&M’ sh.p.k Robert Marku i cili kërkoi pranimin e kërkësë-padisë, pala e paditur nuk u dëgjua pasi ishte në mungesë, dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V È R E N

Se pala paditëse Shoqëria ‘R&M’ sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës Administrative Vlorë me kërkësë-padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkësëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit



“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative e gjykin e mosmarrëveshjeve administrative”, çështja objekt gjyki i një juridikcionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze te nenit 12 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative”, gjyki u zhvillua me trup gjykues te perbere nga një gjyqtar.

Rrethanat e faktit

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse Shoqëria ‘R&M’ sh.p.k, ushtron veprimtarinë me objekt’ import, eksport, me shumicë dhe pakicë e mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industrialë’ vërtetuar nga ekstrakti i QKR-së.

Kjo shoqëri është njoftuar për “Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.8633 prot, dt.04.06.2014, për detyrimet, gjobë për deklarim, pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore, detyrimet, gjobë për deklarim, pagesë të vonuar për tatim mbi të ardhurat personale dhe tatim fitimi.

Pasi ka bërë ankim administrative në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, me vendim të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr, 17413/1 prot. datë .01.09.2014 është vendosur: ndryshimi i aktit administrativ njoftim vlerësimi objekt apelimi e nr.8633, datë 04.06.2014 të Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Fier.

Shfuqizimin e gjobave për sigurimet shoqërore e shëndetësore për procedurën shtator 2006 -shtator 2008 në shumën 250.000 lekë dhe shfuqizimin e dy gjobave në shumën 20.000 lekë për mos deklarim të tatim fitimit për vitin 2007-2008.

Lënien në fuqi të gjobave për sigurimet shoqërore e shëndetësore në shumën 180.000 lekë dhe gjobave për tatim mbi të ardhurat personale në shumën prej 17.000 lekë për periudhën tetor 2008 -mars 2010.

Drejtoia e Apelimit Tatimor ka arsyetuar se është kompetente për faljen e gjobave për periudhën 2006-2008 sipas ligjit nr.9986, datë 11.09.2008 ‘për faljen e detyrimeve tatimore për gjobat dhe kamavonesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara dhe nuk është kompetente për faljen e gjobave pas vitit 2008-2010 pasi bazuar në ligjin nr.10418, datë 21.04.2011 ‘për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit doganor dhe tatimor’ nuk është pjesë e organeve përgjegjëse për këtë falje.

Pala paditëse e kundërshton njoftim vlerësimin tatimor si akt administrative për këto arsyе;

Së pari; shoqëria nuk ka kryer asnje transaksion dhe aktivitet, dhe nuk ka as magazinë dhe as dyqan dhe meqënëse nuk kishte kryer aktivitet ka bërë kërkesë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Fier për mbyllje të aktivitetit në mars 2006 dhe për këtë kërkesë i është bërë dhe kontroll datë 20.04.2006 ku në fund të raportit shprehët se shoqëria nuk ka detyrime tatimore dhe i plotëson kushtet për mbyllje, dhe me këtë kontroll, administratori ka menduar se shoqëria e ka mbyllur aktivitetin.

Së dyti; kur paraqitet në janar 2014 në Drejtorin Rajonale të Tatimeve Fier

për tu pajisur me vërtetim se nuk ka aktivitet, nuk e lëshojnë vërtetimin pasi kjo shoqëri nuk është çrregjistruar dhe figuron, dhe pasi ka dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore është çrregjistruar.

Së treti, kanë dalë dy ligje përfaljen e gjobave dhe nga pala e paditur duhet të ishin falur të gjitha gjobat;

Gjkata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkësë-padia është pjesërisht e bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të pranohet dhe përfjese tjetër duhet të pushohet.

Arsyetimi ligjor

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "

Të drejtën e padisë e ka:

a) organi i administratës publike, që pretendon se është cënuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast organi mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshje së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit.

Rezulton se pala paditëse shoqëria 'R&M' sh.p.k ka një interes legitim përfërshi kërkuar anullimin e njoftimit vlerësim-tatimor me nr.8633 prot, datë 04.06.2014 përsye se pala e paditur në nxjerrjen e këtij akti administrativ nuk ka zbatuar ne mënyrë të drejtë ligjin "Për procedurat tatimore".

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe udhëzimi nr.24, datë 02.09.25008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në ligjin nr. 10 418, datë 21.4.2011 "përfundimini e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor", në nenin 24 të tij parashikohet se "*Të gjithë tatimpaguesve, persona fizikë dhe juridikë, të cilit nuk kanë derdhur të gjitha detyrimet e kontributive të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lidhura me periudhën deri më 31 dhjetor 2010, u falen të gjitha shumat e gjobave dhe të kamatëvonesave.*"

Rezulton se pala paditëse ka detyrim në formën e gjobës përfunditive sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfundimtar 2008-2010.

Përsa i përket detyrimi tatimor në shumën prej 170.000 përfundim mbi të ardhurat personale, gjykata çmon se këto detyrime nuk janë objekt i faljes por bazuar në ligjin 'për procedurat tatimore' gjykata çmon se duhet të anullohen dhe këto detyrime pasi rezultoi e provuar nga gjykimi se pala paditëse nuk ka ushtruar aktivitet nga mars 2006 -qershori 2014 dhe nuk mund të penalizohet me gjobë një subjekt që nuk ka pasur aktivitet ekonomik dhe fitimprurës.

Sa më sipër, gjykata çmon se kërkësë padia duhet të pranohet pjesërisht përsëri sa i përket pjesës së detyrimit tatimor që nuk është

shfuqizuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe pushimin për atë pjesë që ajo drejtori ka shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

1. Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë.

2. Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.8633 prot, datë 04.06.2014 nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier vetëm për detyrimet që Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin nr.1741/1 prot, datë 01.09.2014 nuk i ka shfuqizur.

3. Pushimin përsa i përket detyrimeve tatimore të shfuqizuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Per palen ne mungese, ky afat fillon nga dita e neserme e njoftimit te vendimit.

Kundër vendimit të pushimit, mund të bëhet ankim i vecantë në Gjykatën Administrative e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Per palen ne mungese, ky afat fillon nga dita e neserme e njoftimit te vendimit.

U shpall në Vlorë, sot më datë 14.10.2014.

Sekretare

Milena MERSINI

SHPENZIMET GJYQËSORE
Taksa e rregjistrimit

TOTALI

GJYQTARE

Gentiana XHELILI (RROKAJ)

